



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 4747 Prot

Bajram Curri, më 14/12/ 2021

Lënda: Kërkesë për pajisje me aktin e përputhshmërisë për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Tropojë.

AGJENSISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË

Bazuar në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në Vendimin nr.408, datë 13.5.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Vendimin nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Udhëzimin nr.01, datë 22.02.2019 “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të përshpejtuar”, kërkojmë nga ana juaj pajisjen me “Aktin e Përputhshmërisë” për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Tropojë, të hartuar nga bashkia Tropojë.

Me marrjen e “Aktit të Përputhshmërisë” për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Tropojë, do të vijojmë me procesin e miratimit të këtij dokumenti, pranë organeve kompetente, sipas përcaktimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit do të gjeni bashkalidhur dokumentacionin shoqërues, përkatës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETARI BASHKISE

